**Republika e Kosovës**
**Qeveria**
**Ministria për Forcën e Sigurisë**

# NJOFTIM PËR KONTRATË

## FURNIZIM

Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

**Data e përgatitjes së njoftimit: 05.05.2016**

| **Nr i Prokurimit** | **21700** | **16** | **054** | **111** |
|---|---|---|---|---|

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar:** Ministria për Forcën e Sigurisë | | |
| **Adresa Postare:** Objekti i Ministrisë, numri i zyrës 139, Kazerma ‘’Adem JASHARI’ ’rr. Magjistrale Prishtinë-Mitrovice, | | |
| Qyteti: Prishtinë | Kodi postar: 10 000 | Vendi: RKS |
| **Personi kontaktues:** Afrim MAXHUNI | Telefoni: 038/200 13 500 | |
| Email: afrim.maxhuni@rks-gov.net | Faksi: 038/200 13 501 ose 2 | |
| Adresa e Internetit (nëse aplikohet): | http://www.mksf-ks.org/ | |

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët — Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit — Po ☐ Jo ☒

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

### II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim me automjete (xhip ) taktik dhe autoambulanca taktike 4x4 e ndare ne dy pjesë - Lot.**

**Pjesa e pare - Lot 1:** Furnizim me “Automjete (xhipa)4x4 taktike” për nevojat e FSK-së

**Pjesa e dyte - Lot 2:** Furnizim me “Autoambulanca 4x4 taktike” për nevojat e FSK-së

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**

| ☐ **Punë** | ☒ **Furnizime** | ☐ **Shërbime** |
|---|---|---|
| ☐ Ekzekutim<br>☐ Plani dhe ekzekutimi<br>☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☒ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing)<br>☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | |
| Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve | Vendi kryesor i dorëzimit<br>Kazerma ‘’Adem JASHARI’’ | Vendi kryesor i realizimit |

| | Prishtinë | |
|---|---|---|

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë **Jo** ☒

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë** (nëse aplikohet):N/A

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës: Pjesa e pare lot - 1: Furnizim me "Automjete (xhipa)4x4 taktike" ,me pajisjet përcjellëse.**

AK i MFSK-se dëshiron te hy ne mardhënjë kontraktuale me një OE i cili do te ketë kapacitet te nevojshëm për te bere furnizimin me **"Automjete (xhipa)4x4 taktik te terrenit" me pajisjet përcjellëse (Pajisje për vendosjen e armëve si dhe pajisjet për vendosjen e sistemit te komunikimit Radio HARRIS) si dhe mirëmbajtjen – servisimin e tyre përgjatë periudhës garantuese sipas kërkesës ne DT Aneks 1 (specifikacioni teknik i detyrueshëm**) te cilat do te përdoren për njësit e veçanta te Forcës se Sigurisë se Kosovës (FSK), për plotësimin e nevojave dhe standardeve qe kërkohen me qellim te përmbushjes se kapaciteteve operacionale me qellim te arritjes e objektivave ne përmbushjen e misionit te FSK-se sipas misionit qe kane këto njësi dhe vet FSK-ja .

**Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës: Pjesa e dyte lot - 2: Furnizim me "Autoambulanca 4x4 taktike"**

AK i MFSK-se dëshiron te hy ne mardhënjë kontraktuale me një OE i cili do te ketë kapacitet te nevojshëm për te bere furnizimin me **"Autoambulanca taktike" te terrenit përfshire edhe pajisjet përcjellëse profesionale (Pajisje medicina le ) si dhe pajisjet shtese te veçanta ( Pajisje për vendosjen e armëve si dhe pajisjet për vendosjen e sistemit te komunikimit Radio HARRIS) si dhe mirëmbajtjen – servisimin e tyre përgjatë periudhës garantuese, sipas kërkesës ne DT Aneks 1 (specifikacioni teknik i detyrueshëm)** te cilat do te përdorën për njësit mjekësore për plotësimin e kapaciteteve operacion ale me qellim te zhvillimit te operacioneve mjekësore ne gjithë territorin e Republikës se Kosovës dhe nisur nga fakti tjetër qe konfiguracioni gjeografik i shtrirjes se territorit tone përfshi zonat rurale dhe malore, atëherë është mese e domosdoshme qe te jemi te pajisur edhe me autoambulanca taktike 4x4 me qellim te arritjes e objektivave ne përmbushjen e misionit te FSK-se pra gjithmonë ne shërbim te qytetareve dhe institucioneve te vendit tone.

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 34**

**II.1.7) Variantet pranohen** **Jo** ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë** **Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po,*** tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☒ Të gjitha pjesët

**II.I.9) Ne rast te një apo me shume pjesëve** *(nëse aplikohet)*:

**Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:** ***Për te gjitha pjesët – lotët pa kufizim.***

**II.1.10) Informacione lidhur me pjesët (*nëse aplikohen)***

| Nr. i artikullit | **Përshkrimi i shkurtër Pjesa pare – Lot 1** |
|---|---|
| **1.** | "Automjete (xhipa)4x4 taktike" ,me pajisjet përcjellëse. |
| Nr. i artikullit | **Përshkrimi i shkurtër Pjesa e dyte – Lot 2** |
| **1.** | "Autoambulanca 4x4 taktike" me pajisjet përcjellëse. |

**II.1.11) Vlera e parashikuar e kontratës:**

**Pjesa e pare – Lot 1 : 2,500,000.00 €**

**Pjesa e dyte – Lot 2 : 280,000.00 €**

**II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS**

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm**

1. Sasia e planifikuar për blerje **pjesa e pare – lot 1 – furnizimi me "Automjete (xhipa)4x4 taktike" përfshi pajisjet përcjellëse do te jetë 27 copë** , kurse për të gjitha specifikimet, përshkrimet dhe pozicionet teknike referohuni në dosjen e tenderit Aneksi 1.

2. Sasia e planifikuar për blerje **pjesa e dyte – Lot 2 – furnizimi me "Autoambulanca 4x4 taktike" përfshi pajisjet përcjellëse do te jetë 2 copë**, kurse për të gjitha specifikimet, përshkrimet dhe pozicionet teknike referohuni në dosjen e tenderit Aneksi 1.

**II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM**

Kohëzgjatja në muaj / apo ditë / （nga dhënia e kontratës）

apo

Fillimi:

1. **Kontrata për pjesën e pare – Lot 1**, do te hy ne fuqi nga momenti i nënshkrimit te saje ,kurse afati i liferimit te Automjeteve taktike jo me larg se deri me 15.12.2016 nga momenti i nxjerrjes se urdhër blerjes .
2. **Kontrata për pjesën e dyte – Lot 2,** do te hy ne fuqi nga momenti i nënshkrimit te saje ,kurse afati i liferimit te Autoambulancave taktike jo me larg se deri me 15.12.2016 nga momenti i nxjerrjes se urdhër blerjes .

**NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE**

**III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN**

| |
|---|
| **III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit** Po ☒ Jo ☐<br><br>Nëse po, **vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës me kohëzgjatje afati i liferimit + 30 ditë për te dy pjesët - Lotët** |
| **III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata** (nëse aplikohet):<br>• **Themelimi i entitetit ligjor ne përputhje me dispozitat e parashikuara ne dokumentet e tenderit.** |
| **III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës** Po ☒<br><br>1. **Automjetet si dhe pajisjet përcjellëse pjese te këtij tenderi duhet te jene te prodhuara me standarde te BE-se (për te dy pjesët – lotët)**<br><br>2. **OE duhet te ofroj manualet se paku ne gjuhen angleze për përdorim dhe mirëmbajtje për Automjetet (xhipat) taktik dhe Autoambulancat taktike pjese e tenderit. (për te dy pjesët – lotët)**<br><br>3. **OE duhet te ofroj listën e pjesëve rezervë qe nevojiten për mirëmbajtje.- për te dy pjesët – Lotët**<br><br>4. **OE duhet te ofroj manualin sipas prodhuesit qe do te përdorët për mirëmbajtjen e rregullt- servisimin e Automjeteve (xhipat) taktik dhe Autoambulancat taktike sipas kërkesës ne DT Aneksi 1 për periudhën garantuese.**<br><br>5. **OE duhet me shpenzimet e veta duhet te kryej mirëmbajtjen – servisimin e rregullt përfshi furnizimin me pjesët e nevojshme qe nevojitën për mirëmbajtje – servisim gjate periudhës garantuese ne baze te intervaleve te shërbimit( kilometrazhin apo intervalet kohore ) sipas manualit te prodhuesit - për te dy pjesët – lotët**<br><br>6. **Garancionet (nga defektet e fabrikimit për pjesët mekanike ,elektrike, elektroteknike,dhe te ngjyrës) për Automjetet (xhipat) taktik dhe Autoambulancat taktike duhet te ofrohen sipas kërkesës ne DT Aneksi 1(specifikacioni teknik i detyrueshëm)** |

**III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE**

| |
|---|
| **III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:**<br>**Kërkesa 1:** Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. duke përdorur formën në Aneksin 2<br><br>**Kërkesa 2:** Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara |

dorëzimit të tenderit.

**Kërkesa 3:** Një formular ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit

**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**
**Evidenca 1:** Deklaratë nën betim –duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe i vulosur nga O. Ekonomik
**Evidenca 2:** Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore – duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës– **origjinal**
**Evidenca 3:** Vërtetimin nga Gjykata themelore – duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës– **origjinal**

**III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**
**Kërkesa 4.** Certifikata e regjistrimit të biznesit
**Kërkesa 5**. Certifikata e regjistrimit të TVSH-së
**Kërkesa 6.** Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal
**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**
**Evidenca 4**. Kopja e Certifikatës se regjistrimit të biznesit
**Evidenca 5**. Kopja e Certifikatës e TVSH-së
**Evidenca 6**. Kopja e Certifikatës me numër fiskal

**III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar**
**Kërkesa 7**. Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se qarkullimet vjetore gjate tri viteve te fundit ( 2013,2014 dhe 2015) ka qene ne vlere, se bashku për tre vitet , por jo me pak se.

1. Për pjesën e pare – Lot 1 : 5,000,000.00€
2. Për pjesën e dyte – Lot 2 : 500,000.00€

Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 pjesë (lotët), shuma totale e qarkullimit financiar qe kërkohet për Lotët për te cilat ai konkurron duhet të përmbushet nga OE.

**Shembull:** nëse qarkullimi i kërkuar për Lot 1 është 5,000,000.00€ dhe për Lot 2 është 500,000.00€ atëherë kërkesa minimale e qarkullimit e cila duhet te përmbushet nga OE është 5,500,000.00 euro.
**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**
**Evidenca 7.** Raportin ose raportet përkatëse nga një ose me shumë banka mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar nga ndonjë banke e licencuar – **duhet te dorëzohet ne origjinal**

**III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional**
**Kërkesa 8:** Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjte gjate 3 (tri) vitet e fundit (2013,2014 dhe 2015) jo me pak se;
Për lot 1: 3,500,000.00 Euro
Për lot 2: 400,000.00 Euro

Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 pjesë (lote), shuma totale e kontratave te natyrës se njëjte qe kërkohet për Lotët për te cilat ai konkurron duhet të përmbushet nga OE.
**Shembull:** nëse shuma totale e kontratave te natyrës se njëjte te kërkuar për Lot 1 është 3,500,000.00€ dhe për Lot 2 është 400,000.00 €, atëherë kërkesa minimale për shumen totale te kontratave te natyrës se njëjte e cila duhet te përmbushet nga OE është 3,900,000.00 euro.

**Kërkesa 9:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë, tek Autoriteti kontraktues të paktën nga një foto për produkt te ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve te lëshuar nga prodhuesi, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi 1) (p.sh. në formën e një katalogu ) për pjesët të këtij tenderi qe oferton.

**Kërkesa 10:** Operatori ekonomik ne rast se nuk është vet prodhues atëherë duhet të ofroje dëshmi autorizimin nga prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi për shitje te këtyre automjeteve me emër te projektit dhe numër te prokurimit për pjesët të këtij tenderi qe oferton.

**Kërkesa 11:** OE duhet te dëshmoj se ka një servisë dhe/ose një marrëveshje me një servis përkatës te autorizuar ne Kosove për te mundësuar mirëmbajtjen- servisimin e automjeteve pjese te këtij tenderi përgjatë periudhes garantuese.

**Dëshmia e kërkuar dokumentare**

**Evidenca 8:** Listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara gjate tri viteve te fundit 2013, 2014, dhe 2015, **në origjinal, të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik**, te dëshmuara me referenca në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës , për furnizimet e realizuara dhe pranuar , te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës , natyrën e furnizimit dhe vendin e realizimit të furnizimeve.

a. Kur furnizimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve ) te lëshuara nga autoriteti i tillë.

b. Kur furnizimi është bere për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve)te lëshuara nga blerësi i tille.

**Vërejtje:**
Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e pranimeve teknike te furnizimeve.

**Evidenca 9:** katalogu nga prodhuesi: **në origjinal ose kopje** .

**Evidenca 10:** Autorizimi nga prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi. **Duhet të dorëzohet në origjinal ose kopje e noterizuar nga origjinali.**

**Evidenca 11:** Kontrata dhe/ose marrëveshja me servisin e autorizuar ne Kosove për te mundësuar servisimin e automjeteve përgjatë periudhes garantuese. **Origjinal i vulosur dhe nënshkruar.**

**III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar** | **Po** | ☐ | **Jo** | ☒ |

| |
|---|
| **Nëse po,** referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse |
| **III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve** **Po** ☐ **Jo** ☒ |

**NENI IV: PROCEDURA**

| |
|---|
| **IV.1.1) Lloji i procedurës** |
| ☒ **E hapur** |
| **IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim** (procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)N/A |
| **IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave** (procedurë konkurruese me negociata)N/A |
| IV.1.4) Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është :N/A |

**IV.2) KRITERET E DHËNIES**

| |
|---|
| ☒ **Tenderi i përgjegjshme me Çmimin më të ulët për te dy pjesët.** |

**IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE**

| |
|---|
| **IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë** **Po** ☐ **Jo** ☒ |
| **IV.3.2) Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit**<br><br>Afati i fundit për marrjen e dosje se tenderit deri me date 20/06/2016 , ora 15:00h.<br><br>Kërkesat për pjesëmarrje në një aktivitet të prokurimit që shpien drejt dhënies së ndonjë kontrate publike ose kornize , mund të paraqiten në mënyrë elektronike, |
| Dokumentet me pagës **Po** ☐ **Jo** ☒ |
| **IV.3.3) Afati i fundit për pranim të tenderëve**<br><br>**Data 22.06.2016 Koha 13:00h Vendi Objekti i Ministrisë, numri i zyrës 139, Kazerma "Adem JASHARI" rr. Magjistrale Prishtinë- Mitrovice, Prishtinë RKS** |
| **IV.3.4) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve është shkurtuar:** ☐ po ☒ jo |
| **IV.3.5)** A është e nevojshme siguria e tenderit: **Po** ☒ **Jo** ☐<br><br>**Nëse po**, vlera e sigurisë së tenderit<br>**50,000.00€ me kohëzgjatje 120 dite prej datës se pranimit te ofertave për pjesën e pare - lot 1.**<br>**5000.00€ me kohëzgjatje 120 dite prej datës se pranimit te ofertave për pjesën e dyte - lot 2.** |
| **IV.3.6) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:** ditë 90 apo 3 muaj |

**IV.3.7) Takimi për hapjen e tenderëve:**

**Data 22.06.2016 Koha 13:30h Vendi Objekti i Ministrisë, numri i zyrës 139, Kazerma ''Adem JASHARI" rr. Magjistrale Prishtinë– Mitrovice, Prishtinë RKS**

**NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE**

**V.1) ANKESAT**

**Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.**

**V.2) INFORMACIONET SHTESË**

**Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe**

**Ne rast mos përputhje mes gjuhëve dominon gjuha Shqipe**

Shto informacione tjera: NA